




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
dhe Islamic Relief Kosova



Nr.Prot: 08/
Datë:12-09-2024

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 12/09/2024
PRIMLJENO:
M.F.N.D. 08/161

Thirrje për Aplikim

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Organizata "Islamic Relief Kosova" në kuadër të marrëveshjes së arriturë me nr. Prot. 01/928 të datës 07.08.2024 në komunën e Malishevës, do të implementoj projekte në sektorin e bujqësisë blegtorisë dhe zhvillimit rural për fermerët e Komunës së Malishevës, implementon këto projekte siq janë:

- ✦ Serra 100 m2
- ✦ Serra 50 m2
- ✦ Multikultivator
- ✦ Freza traktorit
- ✦ Sperkatëse traktorit
- ✦ Makina mbjellëse të misrit
- ✦ Makina mbjellëse të grurit

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë fermerët të cilët i plotësojnë kriterët:

Kriteret për mekanizëm bujqësor:

1. Të jetë banorë i Komunës së Malishevës;
2. Të ketë së paku 2 hektar tokë të punueshme, dhe të deshmoj me subvencionet e vitit 2024 për të mbjellurat me grurë ose misër, së paku 2 ha (vlenë vetëm për mbjellëse të misrit dhe grurit)
3. Të jetë i regjistruar si fermer me numër të NIF para thirrjes (shpalljes) për aplikim;
4. Të posedoj traktor (për freza, spërkatëse, makina mbjellëse të grurit dhe misrit);
5. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar më parë (dy vitet e fundit nga komuna dhe shoqatat e ndryshme në bashkpunim me komunën);
6. Përparësi kanë fermerët që veprimtari kryesore kanë bujqësinë;
7. Përparësi kanë familjet me fëmijë jetim dhe të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme.
8. Përfituesit duhet të kenë mundësi participimi prej 20% të vlerës së projektit të përfituar;

Kriteret për Serra

1. Të jetë banorë i Komunës së Malishevës;
2. Të ketë mundësi dhe përshtatshmëri për ta realizuar projektin (për sera jo më larg se 100 metra nga shtëpia);
3. Të ketë përvojë në kultivimin e perimeve dhe mundësi për ujitje;
4. Përparësi kanë fermeret të cilët nuk kanë përfituar më parë (dy vitet e fundit nga komuna dhe shoqatat e ndryshme)po ashtu edhe fermerët të cilët veprimtari kryesore kanë bujqësinë.
5. Përfituesit duhet të kenë mundësi participimi prej 20% të vlerës projektit të përfituar

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim;

- ✚ Kërkesën e plotësuar për aplikim
- ✚ Fotokopjen e letërnjoftimit;
- ✚ Çertifikatën e Bashkësisë Familjare
- ✚ Fleta poseduese e tokës;
- ✚ Përparësi kanë familjet me fëmijë jetim dhe të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme.

Afati i aplikimit fillon nga data 12.09.2024 dhe mbaron me 27.09.2024 ora 16;00

Marrja e kërkesës si dhe dorzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën e pritjes (kati i parë) në Komunën e Malishevës (dokumentacioni dorzohet në original dhe një kopje).

Aplikuesit kanë të drejtë të aplikojnë vetëm në njërën nga projektet e mësipërme.

Vrejtje: Dokumentacioni i pa kompletuar dhe i dorzuar pas afatit nuk do të shqyrtohet,


Drejtori DBRZHA-së
Sylë Dukolli ecc. i dip.